

URDHËR
Nr. 300, datë 27.11.2024

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KRITERET E KËRKUESVE PËR
KAPACITETE TË INFRASTRUKTURËS HEKURUDHORE”¹**

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, neneve 39, 40, 41 dhe 42, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, të nenit 70, të ligjit nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Për kriteret e kërkuesve për kapacitete të infrastrukturës hekurudhore”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen administratorët e infrastrukturës dhe sipërmarrësit hekurudhor për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

RREGULLORE
PËR KRITERET E KËRKUESVE PËR KAPACITETE TË INFRASTRUKTURËS
HEKURUDHORE

Neni 1

Objekti

1. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi:

a) i kërkesave për garancitë financiare që kërkon një administrator infrastrukture për të siguruar që pritshmëritë e të ardhurave nga shfrytëzimi i infrastrukturës të jetë i garantuar të cilat nuk tejkalojnë një nivel proporcional me nivelin e aktiviteteve të parashikuara nga kërkuesi për kapacitet infrastrukture hekurudhore, në vijim kërkuesi;

b) i kushteve kur kërkohet një garanci ose një paradhënie dhe nivelin dhe kohëzgjatjen e një garancie financiare;

c) i disa detajeve në lidhje me kriteret për të vlerësuar aftësinë e një kërkuesi për të përgatitur oferta në përputhje me kapacitetin e infrastrukturës.

Neni 2

Qëllimi

¹ Kjo rregullore përaftron plotësisht me rregulloren e Komisionit (BE) nr. 2015/10, datë 6 janar 2015, “Mbi kriteret për aplikantët për kapacitetin e infrastrukturës hekurudhore dhe shfuqizimin e rregullores zbatuese (BE) nr. 870/2014”, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian OJ L 3, 7.1.2015, f. 34–36.

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përmirësimi i performancën së shfrytëzimit të rrjetit hekurudhor nëpërmjet përfshirjes së garancive financiare dhe sanksioneve për veprimet që ndërpresin shfrytëzimin e rrjetit.

Neni 3 **Përkufizimet**

1. Për qëllim të kësaj rregulloreje, zbatohet përkufizimi i mëposhtëm:
“garanci financiare” që nënkupton:
 - a) pagesa paradhënie për të reduktuar dhe parashikuar detyrimet e ardhshme për të paguar tarifat e infrastrukturës; ose
 - b) marrëveshjet kontraktuale me të cilat një institucion financiar, si banka, angazhohet të sigurojë që pagesat e tilla të kryhen në afat.

Neni 4 **Kushtet për garanci financiare**

1. Kërkuesi zgjedh të përmbushë një kërkesë për garanci financiare me anë të pagesës paradhënie ose marrëveshjes kontraktuale në kuptimin e nenit 3. Nëse një kërkues ofron një pagesë paradhënie për tarifat e infrastrukturës, administratori i infrastrukturës nuk kërkon në të njëjtën kohë garanci të tjera financiare, për të njëjtat aktivitete të parashikuara.
2. Administratori i infrastrukturës kërkon garanci financiare kur vlerësimi i gjendjes financiare të kërkuesit sugjeron se ai mund të ketë vështirësi në kryerjen e pagesave të rregullta për tarifat e infrastrukturës. Administratori i infrastrukturës përmend vlerësimet e tilla të gjendjes financiare në seksionin mbi parimet e tarifimit të deklaratës së rrjetit të tij, nëse është e aplikueshme. Administratori i infrastrukturës e bazon kërkesën e tij për një garanci financiare në vlerësimet jo më të vjetra se dy vjet të ofruara nga një agjenci vlerësimi financiar ose një ent tjetër vlerësimi profesional.
3. Kërkuesit paraqesin vërtetim mbi vlerësimin e gjendjes financiare (bilanci vjetor, fondet që disponon, përfshirë dispozitat bankare, kapacitetin huamarrës, kreditë; asetet duke përfshirë dhe pronat, të cilat personi juridik mund t’i lerë peng si garanci, kapitalin në përdorim, kostot e blerjeve dhe paradhëniet për mjetet, tokën, ndërtesat, instalimet dhe mjetet hekurudhore, detyrimet që rëndojnë mbi asetet e ndërmarrjes.
4. Administratori i infrastrukturës nuk kërkon garanci financiare:
 - a) nga sipërmarrja hekurudhore nëse një garanci financiare tashmë është dhënë ose paguar nga kërkuesi, i cili nuk është një sipërmarrje hekurudhore, për të mbuluar pagesat e ardhshme për të njëjtat aktivitete të parashikuara;
 - b) nëse tarifa e infrastrukturës duhet t’i paguhet drejtpërdrejt administratorit të infrastrukturës nga një autoritet kompetent në përputhje me udhëzimin nr. 15, datë 14.12.2023, “Për shërbimet publike të transportit hekurudhor të udhëtarëve”.

Neni 5 **Niveli dhe kohëzgjatja e garancive financiare**

1. Niveli i garancive financiare për një kërkues nuk e kalon shumën e parashikuar të tarifave që krijohen si rrjedhojë e operimit të trenit të kërkuar gjatë dy muajve.

2. Një administrator infrastrukture kërkon që një garanci financiare që mbulon tarifat e infrastrukturës të hyjë në fuqi ose të paguhet më pak se 10 ditë përpara datës së parë të muajit në të cilin sipërmarrja hekurudhore fillon operimin e trenave.

3. Nëse kapaciteti ndahet pas kësaj periudhe kohore, administratori i infrastrukturës kërkon garancinë financiare me një njoftim të shkurtër.

Neni 6

Aftësia për të përgatitur oferta në përputhje për kapacitetin e infrastrukturës

1. Administratori i infrastrukturës nuk refuzon një kërkesë për një linjë specifike treni, për arsye se kërkuesi, nuk ofron siguri për përgatitjen e ofertës në përputhje me kapacitetin e infrastrukturës, sipas kuptimit të nenit 42, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, përveç nëse:

a) aplikanti nuk i është përgjigjur dy kërkesave të mëparshme për dhënien e informacionit të kërkuar ose është përgjigjur vazhdimisht në një mënyrë që nuk plotëson kushtet e përcaktuara në deklaratën e rrjetit, të përmendur në nenin 28 të ligjit më sipër;

b) administratori i infrastrukturës është në gjendje të demonstrojë, me kërkesën e autoritetit rregullator, se ka marrë të gjitha hapat e arsyeshëm për të mbështetur dorëzimin korrekt dhe në kohë të kërkesave.

Neni 7

Dispozitat kalimtare

1. Kur është e nevojshme, administratorët e infrastrukturës i përafrojnë deklaratat e rrjetit me dispozitat e kësaj rregulloreje.

2. Kjo rregullore është e detyrueshme në tërësinë e saj dhe drejtpërdrejt e zbatueshme në të gjithë rrjetin hekurudhor.